

# Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimeve të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**P**ërfaqësimi i popullit në institucione shtetërore dhe artikulimi i drejtë i interesave të tyre përbën një nga shtyllat themelore të demokracisë së një shteti. Si përfaqësues të popullit, deputetët nuk mund të ushtrojnë pozita tjera publike për arsye se për qëndrimi ndaj përmbushjes së detyrave të besuara të jetë maksimal. Në të njëjtën kohë, deputetët përveç pagës fikse për punën e tyre, gëzojnë edhe përfitime tjera siç është rasti i kompensimit të shpenzimeve për udhëtime.

Publikimi në media i shpenzimeve të udhëtimit nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nxiti reagime të shumta në publik, teksa u ngritën edhe dyshime për shkelje ligjore nga ana e deputetëve.

Ky punim i shkurtër synon ofrimin e praktikave më të mira për kompensimin e udhëtimit të deputetëve dhe dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Kosovës. Në pjesën e parë do të analizohet baza ligjore aktuale për këtë formë të kompensimit, pjesa e dytë përfshin praktikën e Parlamentit Evropian për kompensimin e udhëtimit të deputetëve. Në pjesën e fundit do të jepen rekomandime se si të rregullohet kjo çështje bazuar në modalitetet e vendeve të tjera.

## Korniza ligjore mbi kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Në përgjithësi, shtesat dhe kompensimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë të përcaktuara me Ligjin për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Deputetit<sup>1</sup> dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>2</sup>. Sipas Rregullore së Punës së Kuvendit:

<sup>1</sup> Ligji nr. 03/L-111 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, neni 14. 2010. Mund të gjendet në <https://dpl.us/bsr> (qasur për herë të fundit me: 14/03/2022).

<sup>2</sup> Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 2010. Mund të gjendet në <https://dpl.us/83p> (qasur për herë të fundit me: 14/03/2022).

Në momentin e verifikimit të mandatit të deputetit, deputeti i gëzon të gjitha të drejtat që duhet t'i ketë si deputet, pra edhe të drejta shtesë, më qëllim të sigurimit të kushteve për ushtrimin me sukses të funksionit që ka, në pajtim me ligjin.

Lartësia e këtij kompensimi është rregulluar me një vendim të veçantë<sup>3</sup> të ish-Kryetarit të Kuvendit të Kosovës në vitin 2011. Sipas këtij vendimi, deputetët kompensohen për shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrje në punimet e seancës plenare dhe në komisionet e caktuara me vlerat si vijon:

deri në 30 km



deri në 60 km



mbi 60 km



Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit në bazë të këtij vendimi, nuk nënkupton vetëm shpenzimet për derivate, por për të gjitha mënyrat e udhëtimit. Në momentin kur deputetët fitojnë mandatin për legjislaturën e re, ata bëjnë regjistrimin duke plotësuar formularët për vendbanimin e tyre. Pas fillimit të punës së Kuvendit, në mënyrë automatike nis llogaritja e pjesëmarrjes së tyre në seanca dhe komisione, dhe në këtë mënyrë bëhet kompensimi përmes formulës së lartëcekur e cila bazohet në vendbanimin e deklaruar.

Deputetëve nuk iu kërkohet dëshmi për shpenzimet mujore të udhëtimit dhe kompensimi bëhet drejtpërdrejt në pagën mujore, pra bëhet pjesë e pagës mujore.

Përveç implikimeve relativisht të larta buxhetore, të cilat për periudhën 2011-2021 arrijnë vlerën 1,158,070.00 euro<sup>4</sup>, kjo formë e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit ka ngritur shqetësimin se është bërë keqpërdorim i parasë publike, me dyshimin që disa deputetë nuk e kanë deklaruar saktë, apo nuk kanë përditësuar adresën e vendbanimit pranë administratës së Kuvendit, duke përfituar kështu kompensime mujore për shpenzime të paqena të udhëtimit.

Në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies, ky model i kompensimit ka mbetur në fuqi për më shumë se dhjetë (10) vite, duke rënduar buxhetin e shtetit si dhe duke shkaktuar një krizë në besimin e qytetarëve ndaj përfaqësuesëve të tyre në Kuvend.

Deputetët duhet të kenë të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të transportit për shpenzimet të cilat janë të pashmangshme, të nevojshme dhe ekskluzivisht në funksion të kryerjes së detyrave parlamentare, por vendimi i ri duhet të bazohet në llogaridhënie dhe transparencë, duke eliminuar mundësitë dhe dyshimet për keqpërdorime.

<sup>3</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. Vendimi 04-V-079. Mund të gjendet në <https://dpl.us/c82> (qasur për herë të fundit me: 14/03/2022). <sup>4</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2022. Shpenzimet e Udhëtimit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2011-2021. Mund të gjendet në <https://dpl.us/e2z> (qasur për herë të fundit me 14/03/2022).

## Modeli i kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale

Si referencë për rregullimin e formës me anë të cilës mund të bëhet kompensimi i shpenzimeve në udhëtim të deputetëve, mund të merret Ligji për Tatim në të Ardhurat Personale<sup>5</sup> (LTAP), konkretisht pika 2.4 e nenit 9. Sipas këtij neni, kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit nuk duhet të jetë pjesë e pagës së përgjithshme, por duhet të jetë i ndarë. Lartësia e kompensimit për kilometër në këtë rast është 0.16 cent dhe kjo nuk tatóhet. Pra, nëse Kuvendi vendos lartësinë 0.16 cent kompensim për një (1) kilometër, pavarësisht distancës totale, shuma në fund do të ishte e patatueshme. Por, nëse Kuvendi vendos që lartësia e kompensimit të kilometrit të jetë, për shembull 0.30 cent, pjesa mbi 16 cent do të duhej të tatóhej dhe kjo praktikë është në përputhje me ligjin.

Ky rregullim mund të përdoret si model referimi, ndërkohë shuma e kompensimit për kilometër mbetet në diskrecion të Kuvendit, institucion ky i cili duhet të përcaktojë lartësinë e tij, duke faktorizuar çmimin e tregut dhe normën e inflacionit. Kompensimi për shpenzimet e udhëtimit nuk duhet të jetë pjesë e pagës së përgjithshme të deputetit, dhe i njëjti duhet të tatóhet në përputhje me LTAP.

## Modeli i kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në Parlamentin Evropian

Në Parlamentin Evropian kompensimet dhe shtesat e anëtarëve të parlamentit (por edhe të shërbyesve civil) përditësohen çdo vit, duke marrë parasysh politikatat ekonomike dhe sociale të BE-së.<sup>6</sup> Ndryshimi i vlerave të kompensimeve përditësohet në bazë të indikatorëve ekonomikë, ku një ndër to është norma e inflacionit.

Masat e reja<sup>7</sup> të cilat kanë hyrë në fuqi nga fillimi i vitit 2022 janë:

- Në rast udhëtimi me makinë, maksimalisht prej 1000 km për udhëtim jashtë ose brenda: rimbursimi llogaritet: 0,56 euro/km;
- për udhëtimet ndërmjet 0 dhe 50 km: 0,25 euro;
- për udhëtimet ndërmjet 51 dhe 250 km: 0,14 euro/km;
- shuma maksimale vjetore që mund të rimbursohet në lidhje me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit do të jetë 4 716 euro;
- shuma maksimale vjetore që mund të rimbursohet në lidhje me shpenzimet e udhëtimit të kryera nga kryetarët e komiteteve ose nënkomiteteve që udhëtojnë për të marrë pjesë në konferenca ose ngjarje që kanë të bëjnë me një çështje me interes evropian që bie në sferën e përgjegjësisë së komitetit ose nënkomitetit të tyre dhe që kanë një dimension parlamentar do të jetë 4 716 euro. Një pjesëmarrje e tillë do të kërkojë autorizim paraprak nga Kryetari i Parlamentit.

<sup>5</sup> Ligji nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Neni 9, pika 2.4. Mund të gjendet në <https://dpl.us/fin> (qasur për herë të fundit me 14/03/2022).

<sup>6</sup> EUR-LEX, *Staff Regulations of Officials of the European*, 1962. Mund të gjendet në <https://dpl.us/sov>.

<sup>7</sup> Official Journal of the European Union, *Decision of the Bureau of the European Parliament of 13 December 2021 amending the Implementing Measures for the Statute for Members of the European Parliament*, 2021. Mund të gjendet në <https://dpl.us/8aq>.

## Disa rekomandime për rregullimin e kompensimit të udhëtimeve të deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Me qëllim të rregullimit sa më të mirë të këtij problemi, D+ rekomandon:

1. Kuvendi i Kosovës të bëjë shfuqizimin e kompensimit automatik për udhëtim për deputetët duke marrë për bazë deklarin e vendbanimit;
2. Kuvendi ta mbështesë rregullimin e kompensimit për udhëtime të deputetëve në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale (LTAP), teksa përcaktimi i vlerave (lartësisë së shumës) të kompensimit i lihet në diskrecion Kuvendit. Ky kompensim nuk duhet të jetë pjesë e pagës së përgjithshme të deputetëve, dhe i njëjti duhet të tatohet në harmoni me dispozitat e LTAP-s;
3. Kuvendi ta bëjë rregullimin e ri të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit të deputetëve në mënyrë sa më të detajuar, duke specifikuar kriteret e kompensimit, formën e kompensimit dhe raportimit, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e mundshme;
4. Vlera (lartësia) e kompensimit të përditësohet çdo vit, duke u bazuar në çmimin në treg të karburantëve dhe normën vjetore të inflacionit;
5. Rimbursimi të bëhet në mënyrë retroaktive, ku duhet kërkuar dëshmi (fatura) për shpenzimet e udhëtimit, qoftë pas çdo udhëtimi ose në baza mujore (kjo të jetë në diskrecion të deputetit). Këto dëshmi duhet t'i dorëzohen administratës së Kuvendit dhe në bazë të tyre të bëhet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit;
6. Të publikohen në formë të detajuar në baza mujore në faqen zyrtare të Kuvendit të gjitha kompensimet financiare për udhëtimet e deputetëve;
7. Kryesia e Kuvendit në vendimin e ri të caktojë një limit mujor të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit;
8. Kuvendi të sigurojë publikun se ata që shkelin rregullin e bazuar në ligj, do të sanksionohen me vendim të Kryesisë apo të Kryetarit të Kuvendit.
9. Të krijohet një mekanizëm i pavarur që verifikon rastet që dyshohen për abuzime tek të gjithat format e kompensimit financiar të deputetëve. Ky mekanizëm i pavarur, duhet të luajë rol proaktiv në menaxhimin sa më të mirë të financave publike dhe i njëjti mund të nxjerrë raport vjetor, ku përfshihet pasqyra e përgjithshme e kompensimeve të deputetëve.

